



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



**KUVENDI KOMUNAL PEJË**

**I. Numër: 400-01/4069, datë: 31 Janar 2023.**

Në bazë të nenit 12. pika 2 (d), të Ligjit Nr.03/L – 040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës datë: 04.Qershor 2008 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 datë: 04.Qershor 2008”) nenit 20 paragrafi 1, pika 1.4. dhe nenit 84. paragrafi 1, pika 1.4. të Statutit të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë: 30. Shtator 2020, e nenit 39 paragrafi 1 i Rregullores Nr.02/2021 per punene e Kuvendit te Komunbse I. Numer: 01-060/017031 dt.09. 03.2021, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 31 Janar 2023, pas Draft - Planit të Menaxhimit të Mbeturineve në Komunën e Pejës për vitin 2023-2027, merr këtë:

**V E N D I M**

**Nr.01/2023**

**Mbi miratimin në parim dhe dhënjen në diskutim publik të  
Draft - Planit të Menaxhimit të Mbeturineve në Komunën e Pejës për vitin  
2023-2027**

1. IPET në Diskutim Publik: Draft – Plani i Menaxhimit të Mbeturineve në Komunën e Pejës për vitin 2023-2027.
2. Diskutimi Publik zgjat 14 ditë, nga dita e shpalljes – paraqitjes së Draft – Planit në tabelen e shpalljeve publike dhe në Ueb faqen zyrtare të Komunës së Pejës.
3. Qytetarët e Interesuar, shoqeria civile dhe grupet e ndryshme të interesit mund të njoftohen me tekstin – përmbajtjen e Draft - Planit të Menaxhimit të Mbeturineve në Komunën e Pejës për vitin 2023-2027, përmes Drejtorisë për Punë Komunale dhe Shërbime Publike në Komunës së Pejës dhe në Ueb faqen zyrtare të Komunës së Pejës.
4. Vërejtjet dhe sugjerimet eventuale në Draft – Rregullorën e lartëcekur, mund të bëhen me shkrim dhe të dorëzohen përmes Zyrës së pranimit – Arkives, për Drejtorinë për Punë Komunale dhe Shërbime Publike në Komunës së Pejës.
5. Vërejtjet dhe sugjerimet duhet të paraqiten vetëm me shkrim dhe në kohën e afatit caktuar me këtë vendim, ngase vërejtjet e paraqitura jashtë afatit nuk do të mirrën parasysh.



**KRYETARËSI I KUVENDIT,**  
**Rexhep Kurtbogaj**